

Emri i Lëndës : E Drejtë e Shoqërive Tregtare II							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 424	B	Pranverë	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00
Lektori		Fatri Islamaj, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program i Integruar					
Përshkrimi		Kursi synon t’i ofrojë studentëve njohuri të avancuara mbi të drejtën tregtare dhe funksionin e saj. Kursi përqendrohet në ezaurimin e mëtejshëm të njohurive kryesore mbi legjislacionin e të drejtës tregtare në Shqipëri, duke u bazuar në shoqëritë tregtare dhe dispozitat konkrete lidhur me riorganizimin e shoqërive tregtare duke përfshirë mbarimin, prishjen, bashkimin, ndarjen, falimentimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare dhe cdo aspekt tjetër të rregullimit dhe funksionimit të tyre. Kursi trajton gjithashtu legjislacionin plotësues lidhur me Qendrën Kombëtare të Biznesit, titujt dhe përgjegjësinë penale të shoqërive tregtare. Po ashtu, kursi trajton hapat e ndërmarrë dhe që duhen ndërmarrë në vijim nga shteti Shqiptar për përafrimin e legjislacionit të së drejtës tregtare me të drejtën e BE-së.					
Objektivat		Kursi ka si objektiv t’i njohë studentët me njohuritë mëtejshme të së drejtës tregtare. Kursi synon të japë njohuritë në lidhje me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare. Kursi i njeh studentët dhe me dispozitat kryesore të së drejtës së BE në fushën e të drejtës tregtare dhe kompanive dhe përqafimin e legjislacionit kombëtar në kuadër të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Europian.					
Konceptet Kryesore		1. Riorganizimi i shoqërive tregtare 2. Auditimi 3. Regjimi tatimor 4. Konkurrenca e pandershme 5. Likuidimi 6. Titujt					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Riorganizimi i shoqërive tregtare: bashkimi, ndarja dhe shndërrimi i shoqërive tregtare Riorganizimi i shoqërive tregtare është proces i bashkimit të dy apo më shumë shoqërive, procesi i ndarjes së një shoqërie dhe/ose ndryshimi i formës ligjore të një shoqërie. Këtu jepen të gjitha hapat që duhen ndjekur për realizimin e riorganizimit. (Fq. 270-283)						
2	Auditimi i shoqërive tregtare Prezantim i përgjithshëm i konceptit auditim dhe përcaktimi i subjekteve që janë të detyruar të auditohen. Po ashtu, shpjegohet rëndësia e auditimit të pavarur duke dhënë dhe raste të ndryshme. (Fq. 240-255)						
3	Parimet e auditimit të shoqërive tregtare Leksioni përqendrohet tek parimet e auditimit si shmangia e konfliktit të interesit, pavarësia, objektiviteti, konfidencialiteti dhe sekreti profesional. (Fq. 243-248)						
4	Mbarimi dhe likuidimi i shoqërive tregtare Ky leksion jep kuprimin e mbarimit apo të prishjes së një shoqërie tregtare dhe likuidimin e saj duke u ndalur tek llojet e likuidimit si likuidim i zakonshëm, likuidim i thjeshtëzuar su dhe pasojat që kanë për kreditorët. Një vëmendje e vecantë i jepet edhe mbrojtjes së kreditorëve gjatë këtij procesi. (Fq.299-315)						
5	Largimi dhe përjashtimi i ortakëve Ky leksion synon të sqarojë konceptin e largimit dhe të përjashtimit të ortakëve dhe të aksionarëve për të gjitha llojet e shoqërive tregtare. (Fq. 228-235)						
6	Grupimet e shoqërive Në këtë leksion do të trajtohet përkufizimi i grupimit dhe i nocioneve të tjera të lidhura më të, detyrimet ligjore që vijnë si pasojë e grupimit duke përfshirë detyrimin për transparencë, detyrimin për garantimin e humbjeve, detyrimi i bësniërisë etj. Gjithashtu, do të ezaurohet përgjegjësia për dëmin e ardhur. (Fq. 256-264)						

7	Pavlefshmëria e shoqërive tregtare dhe akteve të saj Ky leksion përqëndrohet tek dallimi mes pavlefshmërisë së akteve të një shoqërie tregtare dhe pavlefshmërisë së themelimit të saj dhe tek dallimi mes veprimeve tregtare dhe jotregtare si dhe regjimet e pavlefshmërisë sipas ligjit shqiptar dhe legjislacionit të Bashkimit Europian. (Fq. 284-298)
8	Provimi gjysmë final
9	Ligji për Qendrën Kombëtare të Biznesit Ky leksion bën një prezantim të përgjithshëm të ligjit nr. 131/ 2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit
10	Ligji për Qendrën Kombëtare të Biznesit/ Vazhdim Ky leksion bën një prezantim të mëtejshëm të ligjit nr. 131/ 2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.
11	Titujt; Shoqëritë kursim-kredi Ky leksion bën një prezantim të përgjithshëm të ligjit nr. 9879, dt. 21.02.2008 “Për titujt”.
12	Marrëdhëniet koncesionare dhe format e ndryshme të marrëdhënieve koncesionare
13	Legjislacioni penal mbi shoqëritë tregtare Pasqyrim i përgjithshëm i legjislacionit penal duke dhënë argumentet pro dhe kundët të përgjegjësisë penale të shoqërive tregtare, kushtet për ekzistencën e përgjegjësisë penale etj. (Fq. 316-377) Gjithashtu, ky leksion bën një prezantim të përgjithshëm të ligjit nr. 9754, dt. 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.
14	E drejta tregtare dhe Bashkimi Europian Ky leksion bën një prezantim të përgjithshëm të së drejtës tregtare në vendin tonë në funksion të përafrimit të legjislacionit të Bashkimit Europian meqënëse aspirojmë për t’u bërë pjesë e këtij komuniteti.
15	Praktikë gjyqësore Pasurimi i leksioneve duke integruar praktikën gjyqësore lidhur me temat e trajtuara në kuadër të kësaj lënde gjatë semestrit akademik.
16	Provimi Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• 1. Argita Malltezi, E drejta tregtare e shoqërive tregtare (Tiranë: Mediaprint, 2011) • 2. Ligji 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”	
Referenca të tjera	
• 1. Bachner, Thomas, Schuster, Edmund-Philipp, Winner, Martin, Ligji i Ri për Shoqëritë Tregtare, Interpretuar sipas burimeve të tij në të Drejtën Evropiane (Tiranë: Duda, 2009) • 2. Aleks Luarasi, Ligje për Shoqëritë tregtare: praktikë gjyqësore (Tiranë: 2002) • 3. Ligji 9879, dt. 21.02.2008 “Për titujt” • 4. Ligji nr.131/ 2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” • 6. Ligji 9754, dt. 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të përvetësojnë koncepte të avancuara të legjislacionit të së drejtës tregtare.
2	Studentët do të njihen me riorganizimin e shoqërive tregtare.
3	Studentët do të fitojnë njohuri mbi marrëdhëniet koncesionare dhe format e ndryshme të tyre.
4	Studentët do të fitojnë njohuri lidhur me auditimin e shoqërive tregtare.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	50	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	20	20
Provimi final	1	26	26
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			152
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.08
ECTS			6.00